



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 423/1 Prot.

Tiranë, më 19 . 03 . 2026

### V E N D I M

**Nr. 58, datë 19 . 03 . 2026**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 58 Regj., datë 25.02.2026, të znj. K. D, kundër Rektorit të Universitetit “Eqrem Qabej”, Gjirokastrë, në të cilën pretendohet për diskriminim për “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>,

### K O N S T A T O I:

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Bazuar në parashtrimet si dhe dokumentacionin e përcjellë pranë KMD-së nga subjekti ankues, znj. K. D, evidentohet problematika e lindur mes saj dhe subjektit për të cilin pretendon se e ka diskriminuar, kundër Rektorit të Universitetit “Eqrem Qabej”, Gjirokastrë, për të cilën, ndër të tjera, shprehet se:

*“Objekt i kësaj ankese është “Urdhëri i Rektorit nr. 12, datë 16.01.2026, ku citohet lirimi im nga pozicioni Drejtor në Drejtorinë e Kurrikulave, Sigurimit të Brendshëm, Marrëdhënieve me Studentët dhe Teknologjisë së Informacionit, i cili është nxjerrë pa u respektuar asnjë afat procedural për ushtrimin e së drejtës time si punëmarrëse në këtë institucion. Akti administrativ i nxjerrë nga Rektori ka mungesë të theksuar në bazën ligjore dhe nuk ka asnjë lidhje normative me lirimin nga funksioni drejtues apo emërimin në pozicione të tjera administrative. Kjo krijon një mospërputhje të qartë midis normës ligjore të cituar dhe pasojës*

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me akronimin: KMD.

*juridike të prodhuar nga akti, duke e bërë atë të cenueshëm për shkak të mungesës së shkakut ligjor (“causa juridica”).*

*Gjithashtu është shkelur parimi i proporcionalitetit dhe procesit të rregullt administrativ. Vlerësoj se shkarkimi nga funksioni drejtues përbën një masë thelbësore me pasoja profesionale, morale dhe karriere, e cila nuk është paraprirë nga vlerësim performance, dhe nuk është bazuar në procedurë disiplinore. Vlerësoj gjithashtu se kjo masë më e rëndë disiplinore nuk është shoqëruar me asnjë akt konsultimi apo njoftimi paraprak ndaj meje si subjekt i interesuar.*

*Në vijim të procedurave administrative dhe ligjore që unë kam ndjekur, i jam drejtuar Rektorit të Universitetit “Eqrem Çabej”, “Ankesë administrative për revokim të Urdhërit nr. 12, datë 16.01.2026 dhe kërkesë për verifikimin e ligjshmërisë dhe përputhshmërisë së akteve administrative të Universitetit “Eqrem Çabej”, ndërkohë me shkresën nr. 90/1 prot, datë 04.02.2026, me subjekt “Përgjigje ndaj ankesës administrative të znj. K. D për revokim të udhërit nr. 12, datë 16.01.2026”, jam njohur me pretendimet e Rektorit, ku në asnjë rresht të shkresës nuk argumentohen arsye konkrete për lirimin tim nga detyra funksionale por citohen thjesht kompetencat e Rektorit dhe përmendet neni 11/1 të Kodit të Punës, “Mirëbesimi”.*

*Gjatë gjithë karrierës time, 17 vite të plota në Universitetet dhe aktualisht jam në vitin e 18 të punës, kam punuar me Autoritete Drejtuese dhe jam udhëhequr gjithmonë nga parimi i përgjegjshmërisë, korrektësisë, mirëkuptimit, dhënies së mirëbesimit, transparencës dhe respektimit të ligjit. Të njëjtën gjë kam pasur edhe me Rektorin aktual, me të cilin gjithashtu na lidhin 6 vite pune si Zëvendës Rektor, ku në këto vite kam dhënë mbi maksimumin tim dhe mbi përgjegjësitë e mia, në përmbushjen e detyrave të mia funksionale, duke marrë edhe përgjegjësi dhe detyra të cilat i takonin atij si zëvendës Rektor. Prandaj përmendja e nenit 11/1 të Kodit të Punës nga ana e tij është thjesht një opinion jo i mbështetur në fakte, pasi puna ime është e dokumentuar në procese dhe procedura gjatë viteve.*

*Në vijim të procedurave të mia administrative për të kërkuar të drejtën time ligjore, i jam drejtuar Ministrisë së Arsimit, në datën 19.01.2026, me subjekt “Ankesë administrative për revokim të Urdhërit nr. 12, datë 16.01.2026 dhe kërkesë për verifikimin e ligjshmërisë dhe përputhshmërisë së akteve administrative të Universitetit “Eqrem Çabej”. Në vijim Ministria e Arsimit, i është drejtuar, Universitetit “Eqrem Çabej”, me shkresën nr. 548/1 prot, datë 23.01.2026 “Kërkesë për informacion”.*

*Nga ana ime, ankesa administrative, drejtuar Universitetit “Eqrem Çabej” dhe Ministrisë së Arsimit ishte e njëjtë në përmbajtje. Nuk më rezulton i njëjtë argumentimi ligjor i dërguar nga Rektori, kundrejt ankesës time dhe informacionit dhe argumentimit të dërguar në Ministrinë e Arsimit. Ka një mos përputhje të fakteve dhe argumentimit ligjor nga ana e tij.*

*Në qoftë se lirimi im nga detyra do të kishte arsye ligjore dhe funksionale atëherë përse, nuk u cituan në Urdhërin nr. 12, datë 16.01.2026, apo të citoheshin në shkresën me nr. 90/1 prot datë 04.02.2026 “Përgjigje ndaj ankesës administrative të znj. K. D për revokimin e Urdhërit të Rektorit nr. 12, datë 16.01.2026 ” të dërguar nga Rektori..... ?*

*Në vijim të shkresës nr. 138/1 prot, datë 09.02.2026, të Rektorit të UGj-së drejtuar Ministrisë së Arsimit, ju paraqes oponentin time me fakte, mbi supozimet dhe manipulimet e cituara në këtë shkresë.*

*Pretendimet e nxjerra nga Rektori i UGj-së, në lidhje me rrethanat e pretenduara nuk qëndrojnë dhe nuk kanë mbështetje ligjore akte por vetëm opinione të supozuara nga ana e tij dhe i cilësoj si shpifje dhe manipulim të fakteve, në dëm të personit tim nga ana e tij.*

...

*Në asnjë nga "opinonet" e cituara nga Rektori në shkresën drejtuar Ministrisë së Arsimit, as kam vepruar në kundërshtim me ligjin dhe as jam bërë pjesë e ndonjë paligjshmerie, për të cilën duhej të shkarkohesha pa asnjë shkak të mbështetur në prova dhe fakte nga ana e Rektorit.*

*Që prej datës 16.01.2026, në ambientin e punës, unë jam diskriminuar, jam kërcënuar dhe jam fyer me një fjalor jo etik nga Rektori. Në situatën në të cilën ndodhem, përkeqësimi i situatës time nga veprimet e Rektorit kundra meje, ku çdo ditë diskriminohem, kërcënohem dhe manipulohen faktet kundra meje me qëllim shtrembërimin e së vërtetës dhe diskriminimin e personit tim, dëmtimin moral dhe karrierës time, ku thirren në zyrë anëtarë të sfafeve dhe kërcënohen që nuk duhet të më flasin mua. Ngarkimi me detyra ekstra vetëm për të më dëmtuar, diskriminuar personin tim. Zhvillohen mbledhje kërcënuese, vetëm në sektorin ku unë jam aktualisht duke intimiduar edhe punonjësit e tjerë kundra meje.*

*Në përfundim, të gjithë sqarimet tim, në lidhje me pretendimet e Rektorit, për të bërë të vlefshëm një akt administrativ, i cili është i cënueshëm juridikisht, nuk ka transparencë në faktet e cituara, ka manipulim dhe fallcifikim të akteve administrative, duke vijuar përgjatë gjithë kohës me presione, hakmarrje dhe diskriminim ndaj personit tim, vetëm pse unë kërkoj të drejtën në organet administrative ligjzbatuese, gjykatën administrative."*

Pas regjistrimit të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me dokumentacionin provues lidhur me shkakun e pretenduar nga ana e subjektit ankues.

Për këtë arsye, nëpërmjet e-mailit datë 25.02.2026, nga ana e KMD-së, është proceduar me kërkesën për plotësimin e dokumentacionit e informacionit të nevojshëm duke qartësuar e provuar shkakun për të cilin pretendohet diskriminimi, për vijimin e shqyrtimit të ankesës së saj, megjithëse një kërkesë e tillë i është bërë edhe para regjistrimit të ankesës nga specialistja e Drejtorisë së Pritjes së Ankesave pranë KMD-së.

Nëpërmjet e-mailit datë 26.02.2026, subjekti ankues ka dërguar pranë KMD-së, shpjegimet e saj, duke parashtruar ndër të tjera, se:

*"Aktualisht, unë jam në marrëdhënie pune si specialiste e procesit mësimor, që prej datës 16.01.2026, por i jam drejtuar gjykatës për rikthimin tim në detyrën e mëparshme.*

*Diskriminimi im, fillon që pas zbritjes time nga detyra, me datë 16.01.2026, duke më ngarkuar procese dhe punë të cilat nuk janë të mijat, duke më vënë përgjegjësi mbi supe të cilat pozicioni ku unë jam aktualisht nuk i përmban. Vetëm për personin tim del urdhër për ngarkimin me detyra, për të cilat unë i kam kundërshtuar me shkresë, pasi insitucioni është me organe kolegjiale, organe drejtuese, struktura administrative dhe vendimarrëse. Nuk mundet dot të më*

*ngarkojnë detyra të cilat nuk janë të parashikuara dhe të mbështetura, vetëm e vetëm që të më diskriminojnë dhe ulur kokën mua për të ma bërë të pa shmangshme rëndesën psikologjike dhe dëmtimin mendor.*

*Zhvillohen mbledhje vetëm në sektorin ku unë kam ardhur aktualisht, vihen kufinj për mos lëvizur nga zyra në asnjë moment, vetëm e vetëm për të më rënduar mua. Këto mbledhje pa dijeninë tonë regjistrohen me audio, pa u njoftuar më parë regjistrimi i mbledhjeve.*

*Vendosjen e njerëzve (patronazhist), për të kontrolluar mua dhe për të më kapur qoftë në gabimin më të vogël dhe të më hequr fare nga puna.*

*Unë jam person që detyrat dhe përgjegjësitë në punë i di shumë mirë dhe i zbatoj në mënyrë korrekte. Jam personi që vi e para nga puna dhe kam ikur e fundit edhe jashtë orarit të punës (kam punuar pa përfutur asnjë qindarkë shtesë).*

*Diskriminimi ndaj meje qëndron në faktin edhe që Rektori therret njerëz në zyrë dhe ju thotë që jeni mërziutur për K, por ajo i ka hapur luftë Rektorit. Unë nuk i hap luftë njeriut, mua më kanë diskriminuar dhe ofenduar pa të drejtë. Unë thjesht kërkoj të drejtën time legjitime.*

*Unë nuk jam personi i vetëm i cili diskriminohet në këtë institucion, pasi jepen masa disiplinore, shkarkime apo krijohen presione nga Rektori, por kjo nuk më përket mua.*

*Ju sqaroj se Rektori, ishte në një konflikt me një departament, ku unë nuk kam qënë pjesë fare dhe as nuk kam pasur dijeni. Dijeninë e kam marr nga Rektori kur më është kërkuar informacion për procesin mësimor. Ndaj atij departamenti është aktivizuar me Urdhrin e tij, njëسيا e auditit për auditimi e atij departamenti, ndërkohë shefja e departamentit i ka drejtuar sektorit të auditit një shkresë për informacion (shkresa 01). Pas marrjes në dijeni të shkresës së saj, Rektori ka reaguar ndaj meje, duke më kërcënuar, diskriminuar, ofenduar dhe liruar nga detyra.*

*“Koka ime u pre” për opinionet e atij dhe njerëzve që kërkonin vendin tim “pasi unë kisha dhënë vetëm një falenderim të thatë”, dhe unë mund të kisha bërë këtë shkresë. Ndërkohë që unë skam qënë në dijeni të kësaj gjeje.*

*Ndërkohë në shkresën e Rektorit drejtuar Ministrisë për rastin tim, ka opinione dhe jo fakte, ndaj unë kam bërë gjithë parashtrimet e mia. Ka fallcifikim të procesverbalit, sepse është lehtësisht e dallueshme shtesa në procesverbal pas mbylljes ku janë firmat dhe shtesa është shkrim tjetër dhe është shtuar për të më rënduar dhe diskriminuar punën dhe personin tim pranë Ministrisë. Ndërkohë dhe për çështjet e tjera të cituara në shkresën e tyre, unë kam arsyetuar dhe faktuar që të gjitha nuk qëndrojnë. Megjithatë shpifja është vepër penale, për të cilën unë do ndjek hapat e mia.*

*Që nga unë e para dhe shumë të tjerë jemi me asistencë juridike, për konfliktet që na ka hapur Rektori, pasi po përfshihemi në çështje “thashethemi” dhe opinione.”*

**Nëpërmjet e-mailit datë 04.03.2026, subjekti ankues ka dërguar pranë KMD-së, shpjegime të tjera, duke parashtruar ndër të tjera, se:**

*“Diskriminimi im ka nisur që me faktin që unë jam liruar nga një detyrë funksionale, dhe jam ulur në pozicion punë, ndërkohë që gjatë gjithë karrierës time 18 vjeçare kam pasur vetëm rritje në pozicionet që mbaja dhe performancë të lartë në punë. Ky është në akt diskriminimi kundrejt personit tim dhe karrierës time.*

*Për revokimin e urdhrin të lirimit tim, jam e detyruar t’i drejtohem gjykatës pasi ndoqa gjithë rrugët administrative (ankesa drejtuar Rektorit) dhe ankesa drejtuar Ministrisë. Megjithatë nuk mbeti me kaq diskriminimi, por u vijua me diskriminim ndaj personit tim, në shkresën e Rektorit drejtuar Ministrisë, ku ishin përmendur gjëra për të cilat të cilat janë mashtrime dhe manipulime nga ana e tij. Pra nuk është kjo një formë diskriminuese ndaj meje.*

*Urdhri posaçërisht për mua, me detyra funksionale shtese, erdhi pas datës 16.01.2026, për të cilën unë e kam kontestuar dhe kam dhënë gjithë argumentimin tim.*

*Po unë ankoem që nga momenti i largimit tim nga detyra (e cila është e cënueshme juridikisht dhe në procedurë).*

*Po ju përcjell edhe urdhrin me ngarkimin me detyra shtese dhe kthimin e përgjigjes nga ana ime. Megjithatë, unë rrugën ligjore do ta ndjek se jam e detyruar për pa drejtësinë që më është bërë.*

....

*Aktualisht pas kundërshtimit të urdhrin nga ana ime, nuk është bërë asnjë veprim shkresor. Thjesht është mbajtur një mbledhje nga ana e Drejtores së re të emëruar, ku ndër të tjera përveçse kërkonte të ndante detyrat, është përcjellë një urdhër nga ana e Rektorit, që të mos levizim në asnjë zyrë tjetër gjatë orarit zyrtar të punës. Ndërkohë gjithë administrata është tërë ditën në levizje, vetëm zyra jonë monitorohet.”*

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Komisioneri vlerëson se, vetëm fakti që një person posedon shkaqet e mbrojtura, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkaqet e pretenduara, por jo vetëm, duhet të parashtrojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “çdo shkak tjetër”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale specifike.

Dokumentimi i tyre është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin subjekti ankues pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat e pretenduara. Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga subjekti ankues lidhen pikërisht me këto “shkaqe”.

Në këtë kontekst, Komisioneri për të vlerësuar nëse pretendimet e subjektit ankues për trajtim të pabarabartë, të padrejtë e të pafavorshëm të saj nga ana e Rektorit të Universitetit “Eqrem Qabej”, Gjirokastër, vijnë për shkakun e pretenduar, duhet që fillimisht ky shkak të jetë i provuar e dokumentuar para KMD-së, si shkak i njohur nga LMD.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim, Komisioneri vlerëson se, personi i cili pretendon se është diskriminuar për këto shkaqe, por jo vetëm, duhet gjithashtu të parashtrojë fakte nga të cilat mund të vlerësohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë një apo më shumë se një, nga shkaqet e mbrojtura, që në çështjen objekt shqyrtimi paraprak, është “çdo shkak tjetër”.

Sa i takon pretendimit të subjektit ankues për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, i pa dokumentuar dhe i paprovuar, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron, pasi ai nuk është “shkaku” në vetvete.

Ankuesja ka pretenduar se është diskriminuar nga Rektori lidhur me dy aktet e nxjerra prej tij:

- Pretendimi i parë lidhet me Urdhrin nr. 12, datë 16.01.2026 “*Për lirimin nga funksioni drejtues dhe emërimin në pozicionin "Specialist për kurrikulat dhe procesin mësimor", pranë Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Brendshëm, Marrëdhënieve me Studentët dhe Teknologjisë së Informacionit*”.
- Pretendimi i dytë lidhet me Urdhrin me nr. 25, datë 09.02.2026 “*Për Ngarkimin e Koordinatorit Institucional për Ndjekjen e Koordinimin e Procesit të Akreditimit*”.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, së pari:

Pretendimi i ankueses se, dalja e Urdhrit nr. 12, datë 16.01.2026 “*Për lirimin nga funksioni drejtues dhe emërimin në pozicionin "Specialist për kurrikulat dhe procesin mësimor", pranë Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Brendshëm, Marrëdhënieve me Studentët dhe Teknologjisë së Informacionit*”, të Rektorit dhe sjellja e këtij të fundit karshi ankueses, është motivuar si hakmarrje ndaj saj, për shkak se ajo zbaton ligjin dhe jo urdhrat e paligjshme të tij, apo se kërkon të drejtën e saj legjitime, rezulton i paprovuar në akte e shkresa konkrete të cilat, në kontekst të sa më sipër do të duhej të dokumentonin fillimisht se cilët ishin urdhrat e paligjshëm dhënë kundrejt ankueses për zbatim, dhe mandej që ajo t’i kishte kundërshtuar apo ankimuar ato pranë Rektorit apo t’i kishte raportuar instancave të tjera përgjegjëse, që kontrollonin veprimet e Rektorit, *para daljes së Urdhrit sipërcituar*.

Nga shqyrtimi i akteve të depozituara pranë KMD-së, evidentohet se të gjitha aktet shkresore të depozituara nga ankuesja, lidhen me kundërshtimin e Urdhrit nr. 12, datë 16.01.2026, pas daljes së tij.

Kështu, në një rend kronologjik veprimesh, ankuesja fillimisht, me datë 19.01.2026, ka kundërshtuar administrativisht Urdhrin e Rektorit me nr. 12, datë 16.01.2026, duke iu drejtuar shkresërisht Rektorit, lidhur me kërkesën për revokimin e Urdhrit të tij, si dhe për verifikimin e ligjshmërisë dhe rishqyrtim të ankesës së saj.

Po me datë 19.01.2026, ankuesja i është drejtuar shkresërisht edhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, lidhur me të njëjtën kërkesë.

Me shkresën me nr. 548/1 prot., datë 23.01.2026, MAS i është drejtuar Universitetit “Eqrem Qabej” Gjirokastrë, duke i kërkuar përcjelljen e informacionit e dokumentacionit përkatës lidhur me praktikën e ndjekur për Urdhrin nr. 12, datë 16.01.2026, sipas pretendimit të ankueses.

Me shkresën me nr. 90/1 prot., datë 04.02.2026, Rektori, në vijim të shqyrtimit të ankesës së znj. D, i është përgjigjur ndër të tjera se: “*Pas shqyrtimit të kujdesshëm dhe të paanshëm të të gjitha pretendimeve dhe rrethanave të paraqitura, konstatohet se kërkesa për revokimin ose shfuqizimin e Urdhrit të Rektorit me nr. 12, datë 16.01.2026, nuk gjen mbështetje të*

*mjaftueshme në kuadrin ligjor dhe faktik të zbatueshëm. Për rrjedhojë, ky urdhër mbetet në fuqi si akt i nxjerrë nga autoriteti kompetent, në ushtrim të përgjegjësisë, të drejtës për t'u organizuar dhe asaj menaxheriale, në funksion të mbarëvajtjes dhe interesit publik universitar.”*

Në përgjigje të kërkesës së MAS, Rektori me shkresën me nr. 198/1 prot., datë 09.02.2026, ka dërguar informacionin e dokumentacionin e kërkuar.

Ankuesja pasi është njohur me përgjigjen e dokumentacionin e përcjellë nga ana e Rektorit për MAS, ka paraqitur objeksionet e saj pranë Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje .

Me datë 23.02.2026, Agjencia, i ka përcjellë ankueses përgjigjen e institucionit/MAS, duke cituar ndër të tjera, se: *“...ministra përgjegjëse për arsimin nuk mund të anulojë, shfuqizojë aktet e nxjerra nga autoritetet apo organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë....për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punësimit, ndiqet rruga gjyqësore...”*

Nga ana tjetër, citojmë se, për pretendimet për paligjshmërinë e Urdhrit nr. 12, datë 16.01.2026, të Rektorit, ankuesja i është drejtuar me kërkesë-padi, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje, me objekt:

1. *“Shfuqizimin e Urdhrit nr. 12, datë 16.01.2026, të Rektorit të Universitetit “Eqrem Qabej” Gjirokastër.*
2. *Zgjidhjen e pasojave duke detyruar palën e paditur Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër t'i dëmshperblejë paditeses:*
  - *Pagën e 12 muajve për arsye të largimit nga puna pa shkaqe të justifikuara.*
  - *Pagën e 3 muajve për mos zbatim të afatit të njoftimit.*
  - *Pagën e 2 muajve për shkak të mos respektimit të procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës.*
  - *Të vendoset pagesa për 8 muaj për shpërblim për vjetërsi në punë.*
  - *Të vendoset pagimi i diferencës së pagës që rrjedh nga pozicioni i mëparshëm i punës të Drejtorit të Drejtorisë së Kurikulave, Sigurimit të Brendshëm, Marrëdhënieve me Studentët dhe Teknologjisë së Informacionit me atë të Specialistit për Kurikulat dhe Procesin Mësimor nga data 16.01.2026 derisa vendimi gjyqësor të marri formë të prerë.*
3. *Të vendoset rikthimi i paditëses në vendin e mëparshëm të punës”.*

Ndërkohë që, para KMD-së, ankuesja ka pretenduar se Urdhri sipërcituar i Rektorit, është motivuar si hakmarrje ndaj saj, për shkak se ajo zbaton ligjin dhe jo urdhrat e paligjshme të tij, apo se kërkon të drejtën e saj legjitime.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë të hapur shkaqesh<sup>2</sup>. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet

---

<sup>2</sup> Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’, i ndryshuar citon se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me .....ose me çdo shkak tjetër.”

mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh<sup>3</sup>.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”<sup>4</sup>*

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar staturat e tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes *“me çdo shkak tjetër”*, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: *“Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të*

---

<sup>3</sup> Neni 14, I KEDNJ-së: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”*.

<sup>4</sup> Shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese.

*identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”.*

Komisioneri vëren se, “viktimat” e diskriminimit e kanë detyrimin të paraqesin fakte dhe prova nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim apo mbi bazën e të cilave të bëjnë të besueshëm pohimin se është bërë diskriminim.

Pastaj, barra e provës i bartet të paditurit, i cili gjatë zhvillimit të procedurës hetimore duhet të dëshmojë se nuk ka pasur diskriminim, apo se ka pasur arsye ligjore për trajtim të pabarabartë. Komisioneri vlerëson se, diskriminimi<sup>5</sup> karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara nga subjekti ankues lidhur me pretendimin për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Kjo pasi, subjekti ankues nuk ka arritur të provojë, faktobjë apo dokumentojë<sup>6</sup> shkakun e pretenduar si “çdo shkak tjetër” (*kundërshtimin e urdhrave të paligjshëm të Rektorit apo shkeljet abuzive të tij*) në mënyrë që të mund të hetohet më tej, nëse trajtimi i pretenduar të kishte ardhur apo të ishte motivuar e nxitur pikërisht për këtë shkak.

Pretendimi i ankueses se sjellja e Rektorit karshi saj, është motivuar si hakmarrje ndaj saj, për shkak se ajo zbaton ligjin dhe jo urdhrat e paligjshme të tij, apo se kërkon të drejtën e saj legjitime, rezultoni i paprovuar në akte e shkresa konkrete, pasi të gjitha aktet shkresore të depozituara nga ankuesja, lidhen me kundërshtimin e Urdhrit nr. 12, datë 16.01.2026, *pas daljes së tij.*

Pala ankuese nuk provon me fakte e prova se mbart ndonjë nga shkaqet e pretenduara, sipas përcaktimeve të LMD-së. Në kuptim të LMD-së, “*Shkak i mbrojtur është një karakteristikë e identifikueshme, objektive apo personale, ose “status”, nga të cilat individët ose grupet e individëve janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.*”<sup>7</sup>.

Në mungesë të provave e fakteve mbi të cilat supozohet se ka pasur diskriminim, pamundësohet vijimi i procedurës për shqyrtimin e ankesës.

<sup>5</sup> “Diskriminimi” përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

<sup>6</sup> Edhe pas kërkesave të përsëritura nëpërmjet e-mailit, të KMD-së.

<sup>7</sup> <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

Vendimmarrja e Komisionerit duhet të jetë e arsyetuar dhe e argumentuar mbështetur në bazueshmërinë e provave e fakteve në gjykim. Kjo, pasi një moment kyç në gjykimin administrativ është edhe procesi i provueshmërisë mbi faktet objekt verifikimi, gjykimi, mbi të cilat bazohet një vendimmarrje e drejtë.

Faktet që janë objekt i të provuarit merren për bazë për efekt provueshmërie, vetëm kur ato janë paraqitur me saktësi dhe në formën e kërkuar nga ligji gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës. Për të formuar bindjen e tij, organi administrativ, në këtë rast Komisioneri, duhet të marrë parasysh si argumentet që flasin për ekzistencën e një fakti, ashtu dhe argumentet që flasin për mos ekzistencën e tij.

Provat janë të dhëna që merren prej burimeve (subjektit ankues në këtë rast) dhe sipas rregullave të përcaktuara në ligj, të cilat vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet e palëve në proces (neni 11, i Kodit të Procedurës Civile).

Subjekti ankues i cili pretendon diskriminimin, ka detyrimin që të provojë me fakte, shpjegime e prova bindëse, nëpërmjet të cilave duhet të krijojë bindjen se mund të prezumohet diskriminimi.

Pala ankuese nuk parashtroi e depozitoi prova, fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se ka patur sjellje, veprime apo mosveprime të subjekteve përgjegjës që të jenë motivuar nga shkak i pretenduar, pasi fillimisht ajo duhet të plotësonte kërkesën minimale lidhur me provueshmërinë e vetë “shkakut”.

Pra, në analizë të sa më lart, Komisioneri vëren se ka mungesë të theksuar të elementëve të provueshmërisë të shkakut të cilësuar nga ana e palës ankuese. Vetëm pasi subjekti ankues të provonte para KMD-së se mbart e posedon shkakun e pretenduar, atëherë Komisioneri mund të vihej në lëvizje për të kërkuar informacion lidhur me veprimet apo mosveprimet e Rektorit të Universitetit “Eqrem Qabej”, Gjirokastër, lidhur me Urdhrin e tij me nr. 12, datë 16.01.2026.

Për rrjedhojë, për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja “ç” të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ...ç) ... nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim<sup>8</sup>”, Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk duhet të pranohet, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim, e për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj, për shqyrtimin e saj<sup>9</sup>.

---

<sup>8</sup> Për analogji citojmë: Vendimin nr. 163, datë 14.08.2023, të KMD-së, Vendimin nr. 205, datë 19.10.2023, Vendimin nr. 226, datë 06.11.2023, Vendimi nr. 27, datë 23.01.2024, Vendimi nr. 41, datë 13.02.2024, të KMD-së etj.

Së dyti, pretendimin tjetër për diskriminim, ankuesja e lidh me daljen e Urdhrit me nr. 25, datë 09.02.2026 “Për Ngarkimin e Koordinatorit Institucional për Ndjekjen e Koordinimin e Procesit të Akreditimit”, të Rektorit, i cili urdhëron si më poshtë citohet:

“1. Ngarkohet Koordinatori Institucional zj. K. D me përgjegjësinë për organizimin, koordinimin dhe ndjekjen e të gjitha fazave të procesit të akreditimit, sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara nga ASCAL.

2. Koordinatorin institucional ka për detyrë:

- Të sigurojë komunikimin institucional dhe teknik me ASCAL dhe strukturat përkatëse të sigurimit të cilësisë;
- Të koordinojë ngritjen dhe funksionimin e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm (GVB);
- Të organizojë procesin e vetëvlerësimit dhe përgatitjen e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB);
- Të ndjekë përgatitjen dhe dorëzimin në afat të Dosjes së Akreditimit dhe dokumentacionit mbështetës:
- Të koordinojë përfshirjen e njësive akademike dhe administrative në përmbushjen e standardeve të cilësisë;
- Të sigurojë përditësimin e të dhënave dhe ngarkimin e dokumentacionit në sistemet elektronike përkatëse;
- Të organizojë logjistikën dhe mbështetjen institucionale gjatë vizitave të Grupit të Jashtëm;
- Të ndjekë zbatimin e rekomandimeve, kushteve dhe masave përmirësuese që rrjedhin nga procesi i akreditimit;
- Të raportojë periodikisht tek Rektori mbi ecurinë e procesit dhe problematikat evidentuara.”

Nëpërmjet shkresës me nr. 219 prot., datë 10.02.2026, ankuesja i është drejtuar Rektorit me kërkesë për rishikim të këtij Urdhri, në përputhje me pozicionin aktual të punës, duke parashtruar se Urdhri është në tejkalim kompetencash të Koordinatorit Institucional. Nëpërmjet kësaj shkrese, ankuesja parashtron, ndër të tjera, se: “Në mungesë të këtij rishikimi, çdo ngarkim me detyra ekzekutive dhe mbikëqyrëse mbetet jashtë kufijve dhe kompetencave funksionale të pozicionit.”

Në komunikimin e mbajtur me KMD-në, ankuesja është pyetur se cilat ishin veprimet hakmarrëse apo masat e ndërmarra kundrejt saj nga Rektori, pas daljes së Urdhrit nr. 25, datë 09.02.2026, dhe kundërshtimit (kërkesës për rishikim) të tij, për të cilin dhe ka pretenduar se ndihet e diskriminuar pasi e ngarkon me detyra që nuk i korrespondojnë pozicionit të saj aktual si specialiste.

Periudha për të cilën ankuesja shprehet se ndihet e diskriminuar nga Rektori, lidhet ngushtësisht me daljen e Urdhrit nr. 25, datë 09.02.2026, pra nga data 09.02.2026 deri në momentin e paraqitjes së ankesës pranë KMD-së, me datë 25.02.2026, pra, një periudhë rreth 12 ditore (ditë pune).

Ankuesja deklaron se, pas kundërshtimit të këtij urdhri, nuk është ndërmarrë asnjë veprim shpresor kundrejt saj. Por pretendon se, pavarësisht sa më sipër, ajo ndihet e diskriminuar, duke cituar se: *“...vetëm në sektorin ku kam ardhur unë vihen kufij për të mos lëvizur nga zyra, vetëm e vetëm për të më rënduar mua. Vendosja e njerëzve (patronazhistëve) për të më kontrolluar mua e për të më kapur në gabimin më të vogël. Unë jam person që detyrat e përgjegjësitë i zbatoj në mënyrë korrekte. Jam personi që vi e para dhe iki e fundit nga puna...”*.

Në vijim, ankuesja shprehet se, bazohen në urdhra verbalë të Rektorit, komunikuar në mbledhjen e Sektorit ku ajo punon.

Si përfundim, për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ankesa e znj. D për këto pretendime, as prima facie nuk plotëson kushtet ligjore për të proceduar më tej me shqyrtimin e saj.

Megjithëse ankuesja është njoftuar nga KMD, për plotësimin e ankesës në përputhje me kriteret ligjore, përsëri edhe me shpjegimet e reja, ankesa paraqitet me të meta, në dy aspekte:

- Përcaktimit, provueshmërisë së shkakut të diskriminimit, i cili duhet të shpjegohet e argumentohet sipas situatave konkrete, në kontekst të “çdo shkak tjetër”. Pretendimi se është diskriminuar për “çdo shkak tjetër”, nuk nënkupton se ky shkak duhet të mbetet i pashpjeguar, i paargumentuar apo i pa provuar, siç ka vepruar ankuesja, në ankesën e paraqitur.
- Nga leximi i pretendimeve të ankueses për akte e veprime diskriminuese, ato janë të karakterit hipotetik e të pashtjelluara, si: *“Jam kërcënuar, fyer me një fjalor jo etik nga Rektori...Çdo ditë diskriminohem, kërcënohem dhe manipulohen fakte kundra meje... me qëllim diskriminimin e personit tim... Thirren në zyrë anëtarë të stafit dhe kërcënohen se nuk duhet të flasim me mua...Zhvillohen mbledhje kërcënuese vetëm në sektorin ku jam unë...është përcjellë një urdhër nga ana e Rektorit që të mos lëvizim në asnjë zyrë tjetër gjatë orarit zyrtar, ndërkohë që e gjithë administrata është tërë ditën në lëvizje, vetëm zyra jonë monitorohet...”*

Pra, përveçse ankesës i mungon shtjellimi i argumentuar e koherent, nuk bazohet as në indicje të ndodhura e të paraqitura në mënyrë të tillë që të dyshohet për akte e sjellje diskriminuese, çka është kusht i domosdoshëm për vijim e shqyrtimit të mëtejshëm të ankesës nga Komisioneri.

Për më tepër, Komisioneri vëren se, ankuesja nuk ka depozituar ndonjë provë dhe nuk parashtron fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se sjellja apo veprimet e Rektorit, e kanë cenuar atë pas daljes së Urdhrit nr. 25, datë 09.02.2026, dhe faktit se e ka kundërshtuar atë.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, shkronja “b”, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ky kërkim i paraqitur nga znj. D nuk mund të pranohet, pasi është i papajtueshëm me dispozitat e ligjit dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj<sup>10</sup>.

<sup>10</sup> Për analogji citojmë vendimet: nr. 240, datë 27.11.2018, nr. 134, datë 16.05.2024 dhe nr. 138, datë 16.05.2024, të KMD-së.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b/ç, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës me nr. 58 Regj., datë 25.02.2026, të znj. K. D, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**